

PROBLEMET QË CËNOJNË MIRËQENIEN E BANORËVE NË FSHATRA DHE QYTEZAT E KOSOVËS

Qershor, 2017

Hyrje

Qëllimi i përpilimit të këtij raporti është, nxjerrja në pah e problemeve më prioritare me të cilat përballen banorët e komunave më të vogla të Kosovës. Këto komuna për arsye të ndryshme janë lënë mënjane, qoftë nga qeveria lokale, qendrore apo edhe organizata të shoqërisë civile.

Raporti shpalos në mënyrë të detajuar problemet e natyrave të ndryshme, të cilat vijnë direkt nga zëri dhe raportimi i qytetarëve dhe që i takojnë sektorit të infrastrukturës, arsimit, kulturës, shëndetësisë. Por mbi të gjitha problemi më i mprehtë është papunësia dhe papunësia e të rinjve i afekton të gjitha këto komuna. Një vend të rëndësishëm në raport gjejnë dhe idetë e rekomandimet e banorëve për modalitetet e zgjidhjes së problemeve.

Raporti është përpiluar nga takimet direkte me banorët e dhjetë komunave të Kosovës, të cilat për kah numri i banorëve janë më të vogla se komunat kryesore. Komunat e përfshira në këtë raport janë:

1. Fushë Kosovë, 2. Istog, 3. Kacanik, 4. Kamenicë, 5. Lipjan, 6. Malishevë, 7. Podujevë, 8. Shtime, 9. Viti dhe 10. Vushtrri.

Në secilin takim pjesëmarrës ishin 15-30 persona, të moshave dhe profesioneve të ndryshme, grupe joformale të rinjsh, kryetar të këshillave të fshatrave, OJQ dhe zyrtarë komunal. Ndërkaq, organizimi i takimeve është bërë gjatë muajve Shkurt – Maj 2017.

Përmbledhje

Takimet e FIQ-it me banorë të komunave të vogla janë mirëpritur, pasi që qytetarët ndjenin nevojën e bashkëbisedimit, të shprehjes së brengave dhe pakënaqësive të tyre në raport me qeverisjen lokale dhe atë qendrore.

Brengat e tyre në të shumtën e rasteve lidhen me mungesë transparence nga ana e qeverisjes lokale për investime kapitale (*ku p.sh. në rastin e Shtimes, Komuna ka shpenzuar 1.300.000 euro për pastrimin e lumit Shtimjana, pastrim i cili ende nuk është kryer, dhe në vazhdim, komuna ka lidhur kontratë me një kompani tjetër të Malishevës në vlerë 280.000 euro për rregullimin e shtratit të të njëjtit lum*). Sipas banorëve investime të tilla nuk janë transparente dhe nuk kanë sjellë punësim lokal, apo përmirësim të ambjentit apo infrastrukturës së komunës.

Ndërkaq, për secilën komunë qytetarët kanë theksuar si jetike, *mungesën e vendeve të punës dhe projekteve zhvillimore*, gjë e cila po inkurajon familjet e sidomos të rinjët që t'a lëshojnë vendin duke lëvizur qoftë në kryeqytet apo edhe deri në shtetet evropiane nëpërmjet emigracionit ilegal.

Mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive për të rinjtë, reflektojnë mungesë vizioni, dhe interesi prej pushtetit lokal dhe qendror për të përkrahur rininë me projekte inovative për punësim. Qytetarët shprehen të shqetësuar për mungesën e projekte për rini që do të kishin ringjallur jetën rinore nëpër këto komuna përmes funksionalizimit të shtëpive të kulturës, qendrave rinore apo terreneve sportive.

Një qasje e varfër sociale ndaj qytetarëve në nevojë prej anës së qeverisjes lokale ishte një prej brengave kryesore të qytetarëve të cilët krahasonin vlerat e qytetarisë kosovare gjatë kohës së luftës, solidaritetin në mungesë të shtetit, vlera këto, që po zbehen *duke e shndërruar qytetarin në një vasal të interesave të zyrtarëve lokalë*, apo ata qendror. Sidomos, brengosëse ishte mungesa e vëmendjes dhe veprimeve për të përmirësuar gjendjen e personave me aftësi të kufizuara, nënave vetëushqyese dhe të moshuarve.

Nxënësit e shkollave patën mundësinë të shprehen dhe shqetësimi i tyre më madhor, ishte *cilësia e dobët e mësimdhënies, mungesën e rregullit dhe kontrollit* nga ana e drejtorëve, si dhe faktin tejet shqetësues atë të *përdorimit të substancave narkotike* nga nxënësit brenda dhe jashtë ambientit të shkollës.

Situatë zhgënjyese ishte tendenca tashmë e njohur e *ngulfatjes të sektorit të shoqërisë civile* nëpërmjet krijimit të organizatave “satelit” të politikës, të cilat po e marrin rolin e pamerituar të një shoqërie të mirëfilltë civile, e që e njëjta vlenë edhe për mediat e financuara nga pushteti.

Problem tjetër mjaftë shqetësues ishte edhe *ndotja e ambientit*, i cili ka pësuar një degradim total nga mos *menaxhimi i duhur i mbeturinave, ndotja e lumenjëve, prerja e pakontrolluar e pyjeve, krijimi i deponive ilegale për mbeturina, gurthyesit e pakontrolluar* si dhe *mungesa e investimeve në gjelbërim dhe hapësira publike*.

Çështjet cilat u ngritën nga banorët e komunave e që ishin të përbashkëta për shumicën ndëlidhen me *mungesën e infrastrukturës*, duke përfshirë këtu: mungesën e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, rrugëve, trotuareve dhe ndriçimit publik. Kjo sidomos ishte e theksuar në fshatrat përreth qytezave.

Mungesa e sigurisë ishte një tjetër problem, që u identifikua pothuajse në të gjitha komunat, e sidomos në zonat rurale, ku nxënësit detyrohen që të ecin përgjatë rrugës për shkak të mungesës së trotuareve dhe mungesa e shenjzimit, apo tejkalimit të shpjetësisë, së lejuar nga ngasësit e veturave.

1. Komuna e Fushë Kosovës

Problemet Infrastrukturore

Në këtë komunë një prej problemeve kryesore ishte zgjerimi i pa planifikuar i qytetit, duke shkaktuar kështu probleme të tjera siç është: mungesa e qasjes në rrjetin e kanalizimit në të cilin nuk është investuar që nga viti 2000; mungesa e gjelbërimit dhe parqeve, si dhe mos mirëmbajtja edhe atij pak gjelbrimi në të cilin është investuar. Një problem tjetër tejet shqetësues që është duke e rrezikuar edhe shëndetin e banorëve është përdorimi i gypave të Azbestit në rrjetin e ujësjellësit, e që njëkohësisht është e ndaluar edhe me ligj. Gjithashtu, ky problem i është adresuar kompanisë së Kompanisë së ujësjellësit, të cilët kanë dhënë premtim që do t'a bëjnë ndrrimin e gypave.

Problemet në menaxhimin e shërbimeve -Si problem kryesor në këtë komunë është mos funksionimi i duhur i sistemit të menaxhimit të mbeturinave. Banorët u ankuan se mbeturinat vërehen kudo, gjë e cila ndodhë nga mungesa e kontejnerëve dhe shportave, por edhe nga mungesa e vetëdijes qytetare për ta ruajtur ambientin. Banorët kritikuan edhe orarin e papërshtatshëm për mbledhjen e mbeturinave, që ndodhë në kohën më të ngarkuar të fluksit të qytetarëve dhe automjeteve.

Siguria -Çështje tjetër që u ngrit nga banorët e Fushëkosovës ishte edhe mungesa e sigurisë në komunikacion. Kjo ndodhë për arsye të tejkalimit të shpejtësisë së lejuar, mungesës së shenjave të komunikacionit, si dhe mungesës së kontrollave policore. Ndërkohë, të njëjtat rrugë frekuentohen edhe nga nxënësit, e që fatkeqësisht numri i aksidenteve është shumë i madh dhe shumë shpesh ato përfundojnë edhe me fatalitet. Prandaj, si tejet e nevojshme, u vlerësua intervenimi i policisë dhe vendosja e më shumë shenjave të komunikacionit, e cila do të mund t'a parandalonte dhe zvogëlonte numrin e madh të aksidenteve.

Arsimi dhe Punësimi -Mungesa e shkollave fillore dhe qerdheve publike është preokupim i madh për banorët e Fushëkosovës. Kjo ndodhi për shkak se qyteti u zgjerua dhe u popullua me ritëm të shpejt, mirëpo pa ndonjë plan të mirëfilltë. Për pasojë, disa banorë detyrohen t'i dërgojnë fëmijët e tyre edhe në shkollat e Prishtinës, e që përcillet edhe me probleme të tjera për prindërit, të cilët ngarkohen edhe më shumë me transportimin e tyre dhe brengën e mungesës së sigurisë në komunikacion.

Problemet e rinisë- Papunësia është një prej problemeve më kryesore për të rinjtë e kësaj komune dhe si e tillë kërkon zgjidhje të menjëhershme, afatgjatë dhe të qëndrueshme. Ndërkaq, si tejet brengosëse ishte edhe mungesa e vëmendjes ndaj rinisë, e cila në pamundësi të angazhimit në aktivitetet rinore, është e çorientuar, qëndron pasive pa pasur mundësi të realizimit të potencialit të vet. Mungesën e vëmendjes e dëshmojnë edhe mos funksionimi i dy institucioneve mjaft të rëndësishme për rininë, si Biblioteka dhe Shtëpia e Kulturës. Gjithashtu, qendra rinore e

cila ka për mision angazhimin e rinisë, udhëhiqet nga persona të afërt me politikën dhe të paaftë dhe të për të drejtuar qendra rinore.

Rekomandime

- Duhet të ketë iniciativa vullnetare për të rregulluar disa prej gjërave në komunë, në mënyrë që të mos të pritët gjithëmonë dhe gjithcka të rregullohet nga komuna ose shteti
- Duhet të ketë më shumë vëmendje ndaj rinisë dhe projekteve që do ta aktivizonin atë
- Duhet të intervenohet në sanimin e problemeve infrastrukturore dhe shërbimeve komunale
- Duhet të ketë planifikim më të mirë në ndërtimin e qytetit, hapësirave publike dhe gjelbërimit
- Bizneset duhet të kushtëzohen për t'a marr nga një punëtor që është banor i fushëkosovës
- Të kushtëzohet regjistrimi i fëmijëve në shkolla fillore me regjistrim të banorëve – sepse ky fenomen po shkakton probleme në reflektimin e drejtë të numrit të banorëve dhe aktivizimit qytetar

2. Komuna e Istogut

Për rininë e komunës së Istogut si problem prioritar ishte papunësia dhe punësimi në bazë të nepotizmit, e cila është duke i pamundësuar kuadrove të reja dhe kualitative që të ftiojnë një vend pune. Ndërkaq, mungesa e aktiviteteve dhe projekteve për rini, po bëjnë që qytetit të zbrazet cdo dite. Rinia kërkoj që qendra rinore dhe shtëpia e kulturës të jetë më aktive në realizimin e projekteve për të rinjë. Në këtë komunë pati kritika edhe për mos funksionalizimin e sallës sportive, e cila për shkak të keq qeverisjes, renovimi nuk ka mbaruar për 9 vite me radhë.

Banorët e Istogut u ankuan se mungojnë projektet në entin e punësimit për ofrimin e kurseve të profesioneve të ndryshme, të cilat sado pak do ta kishin ulë nivelin e papunësisë. Gjithashtu, të rinjtë u ankuan edhe mungesën e fondeve për situmulimin dhe përkrahjen e individëve që deshirojnë të hapin biznes apo të merren me bujqësi.

Ndërksa, sa i përket zhvillimit ekonomik, u theksua mungesa e subvencioneve në bujqësi, si dhe orientimi për produktet që mund të jenë më profitabile, detyrë kjo që duhet të bëhet nga shteti. Përpos kësaj, u kritikua edhe mungesa e orientimit të hershëm në karrierë dhe mungesa e profesioneve të cilat kërkohen nga ekonomia e tregut, e që është parakusht për të pasur një nivel më të lartë të punësimit.

Ndësa, për sektorin jo qeveritar u theksua mungesa e përkrahjes për projektet e organizatave joqeveritare të kësaj komune, mungesës së bashkëpunimit në mes të OJQ-ve, e që ishte shumë më e mirë deri në vitin 2010. Kjo gjë ka ndikuar edhe në kufizimin aktivizimit dhe mobilizimit qytetar për ngritjen e ceshtjeve me rëndësi.

Në këtë komunë pati edhe ankesa nga grupet e marginalizuara, sic janë gratë dhe nënat kryefamiljare, të cilat përpos që nuk gëzojnë asnjë përkrahje nga shteti ato nuk mund të gjejnë as një vend pune. Si pasojë, ato ballafaqohen me sfida të mdha dhe shumë shpesh, fëmijët e tyre nuk kanë mundësi të njëjta sikurse moshatarët e tyre, me c'rast ata nuk arrijnë të kenë edukimin dhe zhvillimin e duhur.

Rekomandime

- Të freskohen kurikulat shkollore të shkollave profesionale dhe të investohet në profesione që kërkohen nga tregu.
- Përkrahja e hapjes së bizneseve nga gratë dhe të rinjtë
- Përkrahja e OJQ-ve me donacione dhe ngritja e nivelit të bashkëpunimit në mes tyre
- Aktivizimi i Rinisë përmes aktiveve të ndryshme edukative
- Investimi në shtëpinë e kultures – Sallën e kinemasë – ku do të shfaqeshin filma edukativ për rinjtë dhe nxënësit

3. Komuna e Kaçanikut

Një prej problemeve kryesore në këtë komunë, ishte papunësia, e sidomos tek të rinjtë që ishte 60%, e që nuk ka ndryshuar që nga viti 2010. Kjo dëshmohet edhe më numrin e madh e atyre që kërkojnë punë në zyrën e punësimit, e që të lajmuar ishin 8000 persona, ndërkaq 750 të tjerë ishin raste sociale. Gjithashtu, si fakt shqetësues ishte, se kjo Komunë është lënë si e izoluar për një kohë të gjatë, e cila ka qenë pasive dhe nuk ka arritur që të siguroj investime nga jashtë dhe projekte të cilat do të kishin ndikuar në zhvillimin ekonomik dhe infrastrukturor të vendit.

Rinia - Ndërsa, sa i përket problemeve që e atakojnë rininë, u theksua mungesa e cilësisë në mësimdhënie, e cila ndërlidhet ngushtë me nepotizmin. Kjo vërehet qartë, sepse mësimdhënësit ndihen komod dhe shumë shpesh vijnë në shkollë si të papërgaditur. Madje, ka raste kur një profesor ligjeron lëndën për të cilën nuk është kompetent. Kritika pati edhe për menaxhimin e shkollave, ku drejtorët zgjidhen në baza partiake dhe pastaj mungon profesionalizmi. Ndërsa, nga pasiviteti i tëprt dhe mungesa e aktivizimit të të rinjëve qoftë në aktivitetë kulturore apo edhe sportive, si problem u shfaq konsumimi i drogës nga të rinjtë e shkollave të mesme. Të rinjtë dëshmuar se kjo mundësohet nga mungesa e palestrave sportive, mos funksionimit të qendrës rinore si dhe mungesës së projekteve që ndikojnë në intergrimin e të rinjëve në shoqëri. Kritika u dha edhe për mungesën e mirëmbajtjes dhe pa kujdesjen dhe ruajtjen e ambienteve shkollore ku janë dhënë donacione të shumëta. Gjithashtu, si problematike u cilësua edhe pa siguri në komunikacion për nxënësit e shkollave fillore, të cilët nga mungesa e trotuareve rrezikojnë të ecin në rrugë.

Ambienti -Sa i përket ambientit, banorët e Kaçanikut e cilësuan atë si tejet të ndotur dhe të degraduar. Ka një sistem të dobët të menaxhimit të mbeturinave, në shumë hapësira ka mbeturina të grumbulluara dhe deponi ilegale, të cilat po ndikojnë në degradimin e tokës. Ndërkaq, ndotja e ajrit u paraqit gjithashtu si problem, e që kryesisht shkaktohet nga fabrika e Gelqeres, e që në të njëjtën kohë banorët nuk janë të informuar sa duhet sepse nuk ka as matje të ndotjes së ajrit.

Shërbimet komunale -Përpos të tjerave, shërbimi shëndetsor u tha që është mjaftë i dobët, dhe shumë shpesh mungojnë edhe mjekët e profileve të caktuara. Rast konkret ishte edhe mungesa e një gjinekologu në këtë komunë, ku pa marr parasysh kushtet financiare, të gjitha gratë detyrohen të udhëtojnë deri në Ferizaj për një kontrollë dhe lindje. Në këtë komunë, vërejtje u dhanë edhe për mos integrimin e personave me aftësi të kufizuar në shkollë dhe aktivitete të tjera (400

persona me aftësi të kufizuara). Kjo situatë ishte edhe më shumë kritike në këtë komunë, ngase shumica e familjeve të tyre jetojnë në varferi të skajshme.

Spektori joqeveritar -Organizatave të shoqërisë civile u ankuan se, ka një diskriminim të madh sa i përket ndarjes së fondeve për OJQ –të e Kaçanikut. Ato u ankuan se, fondet zakonisht merren nga OJQ-të në Prishtinë, të cilat pastaj e shtrijnë aktivitetin në Kaçanik por, pa rezultate të mjaftueshme. Gjithashtu, u theksua se ka mungesë edhe të aktivitetit dhe bashkëpunimit nga forumi i OJQ-ve dhe vet organizatat, si dhe ka një mungesë të madhe të vëmendjes nga mediat qendrore.

Rekomandime

- Zyra ekonomike në Komunë, duhet të jetë aktive për të tërhequr investime në komunë dhe për të rritur punësimin, ngase nga mos punësimi burojnë të gjitha dukuritë negative;
- Kalaja e qytetit ka potencial për zhvillimin e turizmit, ku mund të bëhet një amfiteatër, ndaj edhe duhet të shfrytëzohet;
- Donatorët duhet të orientohen me investime në projekte zhvillimore edhe në këtë komunë
- Duhet të rifunksionalizohet qendra rinore
- Duhet të ketë më shumë përkrahje të organizatave të shoqërisë civile dhe aktivizim më të madh të forumit të OJQ-ve

4. Komuna e Kamenicës

Një prej çështjeve kryesore e cila u ngrit në këtë komunë, ishte **ekonomia e dobët** dhe mungesa e investitorëve për të hapur biznese. Banorët deklaruan se Kamenica është edhe një ndër komunat më të izoluar të Kosovës. Ky problem ka ndikuar që qyteti të zbrazet, ngase duke mos parë perspektivë për jetë, të rinjtë dhe familjet të cilat kanë pasur pak mundësi, janë të parët të cilët kanë lëshuar vendin. Në ndërkohë, pushteti lokal dhe ai qendror kanë qenë tejet pasiv dhe të pavullnetshëm në tërheqjen e investimeve për projekte zhvillimore. Faktor tjetër që ka stimuluar ikjen banorëve nga kjo komunë është edhe zvogëlimi i **ndihmës nga diaspora**, e cila për cdo vit është në rënie e sipër, e që ka shërbyer si mjet kryesor për ekzistencën e familjeve të kësaj komune. Ndërkaq, për të rinjtë e kësaj komune, pushteti lokal nuk ka bërë mjaftueshëm që të mbështesë rininë me aktivitete kulturore, sportive, por edhe projekte të tjera të cilat do të kishin ndikuar në përparimin e rinisë.

Banorët u ankuan edhe për mungesën e **kushteve elementare në shkollën fillore**, e cila është tejet e vjetër, e cila për një kohë të gjatë nuk është renovuar, nuk ka higjienë të mjaftueshme dhe rrezikon vazhdimisht shëndetin e fëmijëve.

Në këtë komunë, u kritikua edhe **menaxhimi i buxhetit komunal**, ku pushteti lokal gjithëmonë gjen fonde për të bërë shpenzime të luksit dhe të pa nevojshme, ndërkaq kur vije fjala tek investimet në dobi të qytetarëve, gjen arsyetim se nuk ka mungesë fondesh. Disa prej tyre, shfaqen ankesa edhe në procesin e ndarjes së banesave për rastet sociale, duke thënë se ka shumë mashtrime në këtë proces, sepse ka raste të tilla që kanë marr banesë mirëpo nuk e kanë statusin e rastit social.

Në anën tjetër qytetarët e Kamenicës, u ankuan edhe për **degradimin e ambientit** dhe mungesën e masave që do ta përmirësonin atë. Konkretisht, ata u ankuan për dëmtimin **e lumit nga eksploatimi**, krijimin e deponisë në pronën e kooperativës dhe mungesën e gjelbërimit. Përpos tjerash, ankesa u bënë edhe në **aspektin e sigurisë në komunikacion**, ku nga shpejtësia e tejkaluar rrezikohet jeta e fëmijëve dhe banorëve të tjerë të cilët lëvizin në qendër. Ankesa u bënë edhe për mungesën e infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuara, gjë që e kufizon lëvizjen e lirë të tyre dhe i bënë ata si një komunitet i izoluar dhe krejtësisht të varur nga ndihmësit e tyre familjar.

Ndërkaq sa i përket sektorit të shoqërisë civile, organizatat e këtij sektori u ankuan se ka një pasivitet të madh, për shkak të mungesës së vëmendjes së donatorëve për të ndihmuar organizatat e kësaj komune, të cilat punojnë në aktivizimin dhe mobilizimin qytetar.

Rekomandime

- Duhet të ketë strategji dhe plan për të dhënë rezultate konkrete për zhvillimin ekonomik të Komunës
- Duhet të investohet në renovimin e shkollës fillore në qendër
- Komuna duhet të reduktoj shpenzimet e luksit dhe të investoj fondet në projekte zhvillimore
- Rinia duhet të aktivizohet përmes projekteve të ndryshme kulturore dhe sportive
- Duhet të përkrahen më shumë OJQ të cilat punojnë në avancimin e shoqërisë
- Duhet të shfrytëzohet potenciali dhe toka për zhvillimin e bujqësisë
- Duhe të ndërmerren hapa konkret në mbrojtjen e ambientit

5. Komuna e Lipjanit

Problemet e Rinisë - Rinia e kësaj komune kritikoi pushtetin lokal por edhe atë qendror për mungesë të vëmendjes ndaj të rinjëve, e cila përmendet shpesh nga politikanët si pasuri, mirëpo në realitet nuk bëhet asnjë investim për t'a aktivizuar atë. Ata u ankuan për cilësinë e dobët në arsim, më konkretisht në gjimnazin e Lipjanit, i cili nuk ofron ndonjë cilësi në mësim, për cka shumë nxënës të mirë e shqyrtojnë mundësinë e transferimit në gjimnazin e Prishtinës. Cilësinë jo të mirë në mësim, e dëshmon edhe fakti që vetëm 20% të maturantëve arrijnë të regjistrohen në Univesitetin Publik, ndërsa për shkak të kriterit më të ulët, 80 % përfundojnë nëpër Kolegje Private. Të rinjtë u ankuan edhe për mënyrën e menaxhimit dhe kontrollit të shkollave, e cila dëshmohej edhe përmes sjelljeve të nxënësve, të cilët shpesh konsumojnë duhan dhe drogë edhe brenda ambientit shkollor. Ndërsa, nga vet të rinjtë, u pranua se rinia e kësaj komune është në rrugën e gabuar, sepse nuk ofrohet edukim cilësor, nuk ka bazë të mirë edukative familjare, nuk ka projekte dhe aktivitete të cilat do të mund t'a orientonin rininë drejtë një zhvillimi dhe avancimit të duhur.

Ndërkaq, sa i përket angazhimit të Kuvendit Rinor Lokal (KVRL), ata u ankuan se nuk kanë kushte të mjaftueshme për të funksionuar si duhet, dhe me gjithë faktin se i është ndarë një zyrë,

ato nuk janë të pajisura me mjetet e nevojshme. Gjithashtu, KVRL u ankuan se drejtorët e shkollave kanë ende një mentalitet i ulët dhe nuk i kuptojnë të rinjtë drejtë. Këtë më së miri e dëshmojnë pengesat që janë shkaktuar nga drejtorët e shkollave, për të mos e lejuar stafin e KVRL-së për të realizuar ligjerata për vetëdijësimin e të rinjëve kundër alkoolit dhe drogës.

Punësimi -Banorët e kësaj komune e në vecanti ata të rrethit të Lipjanit u ankuan për mungesë të vendeve të punës. Duke e ditur se papunësia është burim i shumë problemeve të tjera, e sidomos tek rinia, banorët kërkuar investim dhe inkuadrim të rinisë në ekonomi. Ndërkaq, banorët e fshatrave treguan se ka potencial të madh për zhvillimin e bujqësisë në këtë komunë. Ekzistion tokë e mjaftueshme dhe kualitative, por e cila nuk po arrin që të shfrytëzohet për shkak të mungesës së subvencioneve dhe investimeve.

Infrastruktura - Sa i përket infrastrukturës, banorët e Fshatit Mirenë u ankuan, se nga mungesa e një shkolle të afërt, fëmijët detyrohen të ecin rreth 12 km rrugë për të vijuar mësimin. Ndërkohë, që shumë fshatrave në mas të madhe u mungon ndricimi dhe rreziku iu kanoset nga qent endacak.

Ambienti - Çështje tjetër e cila u diskutua është edhe dëmtimi i ambientit, e cila shkaktohet kryesisht nga menaxhimi jo i mirë i mbeturinave, mungesa e qasjes së banorëve në sistemin e grumbullimit të mbeturinave dhe vetëdija e ulët e qytetarëve për t'a ruajtur ambientin. Ka mungesë të theksuar të gjelbërimit dhe shkatërrim të atij ekzistues, ku me rregullimin e trotuareve janë hequr një numër i madh i drunjëve disa vjecar, të cilët kanë pas mundësinë që të ruhen.

Kjo komunë ka problem të madh me kundërimin e aromës që vjen nga ferma e pulave që gjendet në rrethin e Lipjanit, si dhe kundërimin e lumit Sitnica, i cili tashmë ka pësuar ndotje totale. Degradimi i tokës dhe ambientit është duke ndodhë edhe nga gurëthyesit ilegal, për të cilët edhe janë nënshkruar peticione për të ndal punën. Ndërsa, pasuria më e madhe e kësaj komune po edhe Kombëtare sic është shpella e Gadimes, është duke u shkatërruar çdo ditë nga mungesa e menaxhimit të duhur, dhe politikave shtetërore për zhvillimin e sektorit të turizmit.

6. Komuna e Malishevës

Nga diskutimi me banorët e Malishevës dolën në pah probleme të fushave të ndryshme, duke përfshirë këtu: **mungesën e investimeve në infrastrukturë, mungesën e vëmendjes ndaj rinisë, personave me aftësi të kufizuara, si dhe mungesën e angazhimit qytetar.**

Meqë shumica e pjesëmarrësve në takim ishin të rinjë, dominuan problemet dhe temat, që i preokupojnë më shumë ata. Të rinjtë u shprehën të pakënaqur me qasjen e pushtetit lokal, por edhe qendror ndaj tyre, duke theksuar se problem kryesor mbetet **mungesa e ideve dhe projekteve për t'a integruar talentin** dhe potencialin e rinisë. Vërejtje u dhanë edhe për fushën e arsimit, ku u përmend qasja dhe programet jo adekuate në mësimdhënie, të cilët factor çdo ditë po e mbysin kreativitetin e rinisë. Ankesa kishte edhe për procesin e ndarjes së bursave studentore, ku të rinjtë cekën nepotizmin dhe padrejtësitë si factor që arrijnë të eliminojnë dhe diskriminojnë studentët meritör.

Gjithashtu, ankesa kishte edhe për mungesën e kabineteve për të kryer punën praktike në shkolla (kabinete të teknologjisë informative, kimisë, fizikës, biologjisë). Ndërkaq, ata u shfaqën edhe vetëkritik për mungesën e angazhimit të tyre, ku theksuan se rinia duhet të jetë më aktive dhe të ketë një rol më të madh në për të realizuar ide dhe projekte të cilat do të kenë ndikim në aktivizimin e rinisë. Ata dhanë edhe shembuj konkret arritjet e disa të rinjve në fushën e artit, ku *një grup i të rinjve nga Malisheva me vetë iniciativë ka realizuar një film të metrazhit të shkurtë, i cili ka fituar edhe çmim ndërkombëtar.*

Për pjesëmarrësit e tjerë në këtë diskutim, si problem kryesor doli **mungesa e angazhimit dhe organizimit qytetar**, e që do të shtonte presionin tek organet relevante për zgjidhjen e problemeve të banorëve të kësaj komune. Ata shprehën pakënaqësinë e tyre në lidhje me qasjen e qeverisjes komunale, duke thënë komuna vazhdon ta sheh qytetarin vetëm me probleme në infrastrukturë, duke harruar aspektin social dhe zbatimin e të drejtave elementare të tij.

Banorët kishin ankesa edhe për **mënyrën selective të investimeve kapitale**, nëpërmjet projekteve të cilat diskriminojnë fshatra dhe lagje të ndryshme, ndërkaq përkrahin ato të cilat mund të sjellin votë. Konkretisht, si problem infrastrukturor u vunë në pah **mos investimi në rrjetin e ujërave të zeza, ujësjellësit, ndriçimit dhe rrugëve për persona me aftësi të kufizuara**. Përpos kësaj, u theksua edhe **ndotja e ambientit**, duke përfshirë ndotjen e lumit, krijimin e deponive ilegale të mbeturinave, mos menaxhimit të duhur të mbeturinave nga komuna si dhe mungesën e vetëdijes së qytetarëve për ruajtjen e ambientit. Gjithashtu, si problematikë në këtë komunë ishte edhe prezenca e personave me të probleme mentale, të cilët bredhin në rrugë dhe rrezikojnë sigurinë e banorëve.

Rekomandimet

- Komuna duhet të tejkalojë mentalitetin që e sheh qytetarin me nevoja vetëm infrastrukturor. Por nevojat e qytetarëve të shihen si një tërësi, duke shtuar dhe përkujdesjen në aspektin social;
- Komuna ka nevojë për iniciativa/projekte dhe fushata për emancipim qytetar;
- Duhet të formohet një fond i vecantë për të ndihmuar të rinjtë, që kanë talent dhe potencial për zhvillimin e projekteve të ndryshme zhvillimore;
- Shteti të krijojë plane për integrimin e personave me të aftësi të kufizuara (paaftësi mendore);
- Të intervenohet në programet shkollorë duke i risfreskuar ato me metodat mësimore të reja, si dhe të investohet në kabinetet shkollorë për punë praktike;
- Duhet të ketë më shumë organizim dhe bashkëpunim qytetar për të zgjidhur problemet në komunitet.
- Qendra rinore duhet të përkrahet më shumë me projekte të reja dhe innovative;
- Kryetari i komunës duhet të bashkëpunojë më shumë me kryetarët e fshatrave dhe qytetit.

7. Komuna e Podujevës

Në këtë takim u diskutua një numër i madh i problemeve, të cilat kishin adresa të ndryshme për t'u sanuar, e që kanë të bëjnë me **mungesë të infrastrukturës, degradimin e ambientit,**

mungesën e aktivizimit qytetar, mungesën e aktiviteteve për të rinjtë, mungesën e kushteve për persona me aftësi të kufizuara, papunësinë, e sidomos tek komuniteti Romë dhe Ashkali.

Si problem prioritar u shpërfaq degradimi i ambientit, e që vjen si rezultat mos menaxhimit të duhur të mbeturinave, mungesa e kontejnerëve dhe papërgjegjësia e banorëve e sidomos në fshatra. Nga mungesa e kontejnerëve, ata bartin mbeturinat nga fshati i tyre në një fshat tjetër, me ç'rast bartin edhe problemin pa initiative dhe mbështetje për ta zgjidhur atë.

Ndërkaq kritike u shfaq gjendja e **fshatit Dumnice**, ku janë krijuar **deponi ilegale**, e që dyshohet se ka kontejner edhe me **mjete helmuese** siç janë herbicidët, e që rrezikon në masë të madhe shëndetin dhe jetën e banorëve të këtij fshati. Përpos kësaj, ka edhe deponi me qen të ngordhur, që njëjtë shkakton rrezik të vazhdueshëm për banorët e kësaj ane. Kjo komunë, u ankua edhe për **ndotjen e lumit Llap** nga mbeturinat, i cili gjithmonë është duke u ndotur dhe dëmtuar nga faktori njeri.

Në anën tjetër, si problem u adresua edhe **ndërtimi i hidrocentralit** në fshatin Murgull- nga i cili rrezikohet humbja e ujit nga lumi. Ky termocentral është bërë pa konsultim dhe pajtim të banorëve, ndërkaq është duke u kundërshtuar edhe përmes **peticionit**. Në të njëjtin fshat jetojnë 200 banorë, prej të cilëve 120 vetëm se kanë nënshkruar peticionin.

Problem tjetër që po ashtu ndërlidhet me infrastrukturën, është **mungesa e rrjetit të ujësjellësit** dhe kanalizimit për disa fshatra. Ndërkaq, si absurde u cilësua mungesa e ujit në fshatin Orllan, i cili në të njëjtën kohë furnizon të gjitha fshatrat përveç vetes

Problem tjetër i cili u ngrit në këtë takim ishte edhe **mungesa e sigurisë në komunikacion**, e sidomos për fëmijët të cilët në mungesë të trotuareve dhe nënkallimeve, detyrohen të ecin në rrugë kryesore. Gjithashtu, rreziku në komunikacion vjen edhe nga ndalja e shpesht e autobusëve në vende ku nuk ka stacion. Për shkak të këtyre faktorëve, kjo komunë ka **numër të madh të aksidenteve** rrugore, të cilat marrin jetën e banorëve, e që kërkon zgjidhje urgjente.

Rinia -Si anembanë Kosovës edhe në këtë komunë, papunësia ishte një prej problemeve kryesore për rininë. Ndërkaq, në masë më të madhe të afektuar ishin **komuniteti Romë dhe Ashkali**, si dhe personat me aftësi të kufizuara. Të rinjtë e kësaj komune treguan se ka një mungesë të theksuar të aktiviteteve rinore. Ngjashëm, qendra rinore nuk është sa duhet aktive dhe nuk ka siguruar projekte të cilat do t'a kishin aktivizuar rininë. Kjo ndodhë për faktin se kjo qendër menaxhohet nga persona të cilët nuk janë mjaftueshëm kreativ dhe produktiv për të dhënë më shumë rezultate për përfshirjen e rinisë në aktivitete të ndryshme.

Rekomandimet

- Hapja e **shkollës së Bujqësisë**, meqë kjo komunë ka shumë banorë që merren me bujqësi
- Shtimi i aktiviteteve për të rinjtë në qendrën rinore, por edhe aktivizimi i të rinjve në forma të tjera
- Ofrimi i mundësive për rini, për të kryer punë praktike apo punë vullnetare
- Instalimi i kanalizimit në disa fshatra
- Rritja e sigurisë për nxënësit dhe kalimtarët, që detyrohen të ecin në rrugët magjistrale

- Krijimi i kushteve për persona me aftësi të kufizuara dhe krijimi i parkingjeve në qendër për veturat e tyre

8. Komuna e Shtimes

Puna e Pushtetit lokal- Banorët e Shtimes dhe të rrethit të saj, ishin mjaft kritik për udhëheqësinë komunale, të cilët kritikuan për **mungesë të transparencës** në kontratat publike dhe mospërfshirjen e qytetarëve në vendim marrjes e sidomos për mungesën e informimit të duhur për pjesëmarrje në dëgjimet publike.

Tenderët- Ankesa të shumta pati edhe për stergjatjen dhe mungesën e cilësisë në punët e kontraktuara infrastrurore, gjë që prek rrjetin e kanalizimit dhe ujësjellësit në fshatra. Ka mungesë të theksuar të transparencës për renovimin e shtratit të lumit, i për të cilin disa herë me radhë u dha tender, por që ndryshimet nuk vërehen në terren, njëkohësisht renovimet ende vazhdojnë. Për këtë projekt, ka dyshime në dhënien e kontratës për pastrimin e lumit-Shtimjanja, ku janë shpenzuar 1.300.000 euro, ndërsa puna ende nuk është kryer. Komuna në vitin 2016, sërish ka lidhur kontratë për të rregulluar shtratin e lumit, e që është në vlerë prej 280.000 euro, me kohëzgjatje 2 vite. Për këtë projekt, edhe OJQ POLIS ka bërë kërkesë për qasje në document zyrtare, mirepo nuk i është lejuar asnjëherë qasja.

Siguria- Ka mungesë të trotuareve, shumë shpesh banorët detyrohen të ecin në rrugë, me cka rrezikojnë edhe jetën e tyre nga automjetet. Mungesa e shenjave parandaluese në komunikacion rrugor- sidomos në rrugën tranzitore ku zhvillohet shpejtësi e madhe, e që rrezikon jetën e fëmijëve që shkojnë në shkollë, e që detyrohen të ecin në distancë më të madhe.

Ambienti -Problem tjetër i cili u ngrit gjatë takimit ishte dhe mos menaxhimi i duhur i mbeturinave dhe krijimi i deponive ilegale për shkak të mungesës së kycjes së banorëve në sistemin e grumbullimit të mbeturinave.Ky problem pastaj tërheq edhe një tjetër problem, e që është prezenca e shumë të qenve endacak, e cila njëjtë vështirëson vajtjen e fëmijëve në shkollë.

Papunësia - Sa i përket papunësisë, banorët treguan se shkalla e papunësisë nuk është ashtu sic reflektohet zyrtarisht, sepse ka edhe informalitet në punësim. Ndërkaq ata treguan se ka interesim më të madh të banorëve për tu punësuar në punë që janë më të lehta apo për arsye të veta, ata janë më të interesuar që të punojnë në sektorin publik se sa në atë privat.

Problemet në fushën e bujqësisë dhe blegëtorisë - Banorët e rrethit të Shtimes, u ankuan edhe për sektorin e bujqësisë, duke thënë se ka fshatrat që merren me bujqësi, mirëpo ka edhe shumë sfida në tregtimin e produkteve, sepse nga cmimi i ulët nuk ka ndonjë profit të madh. Ata kërkuar që të bëhen hulumtime më të mira, për të identifikuar produktet në bujqësi të cilat mund të sjellin më shumë fitim, dhe që nuk do të dëmtohen nga produktet e importuara. Gjithashtu, ankesa pati edhe për blegëtori, për të cilën u shfaqen skeptik për çmimet e ulëta, e sidomos të qymështit që është shumë i ulët, me c'rast nuk ka motivim për tu marr me këtë lëmi. Vërejtje u dhanë edhe për subvencionet për bujqësi, të cilat u cilësuan si jo të duhura, ngaqë kërkojnë një pjesë e madhe e investimeve të vij nga vet bujku, e që është 40% e shumës totale.

Kjo gjë limiton në masë të madhe këtë sektor, meqë dihet se popullata në realitet nuk posedon këtë shumë të parave.

Rekomandime

- Komuna duhet të jetë më transparente karshi publikut
- Banorët duhet të përfshihen në vendimmarrje, sidomos me rastin e dëgjimeve publike
- Duhet të ketë subvencione më të favorshme për bujqit
- Duhet të bëhen studime për të identifikuar produktet më profitabile në bujqësi
- Duhet të rritet niveli i sigurisë në komunikacion
- Duhet të ketë strategji dhe plan konkret për përfshirjen dhe aktivizimin e rinisë

9. Komuna e Vitisë

Në këtë komunë, debati u fillua me sektorin shoqërisë civile, i cili po përballet me shumë vështirësi. Në takim u tha se, ky sektor është i ngulfatur nga pushteti, duke tentuar vazhdimisht që të pengohen ato kritike, ndërsa duke bashkëpunuar me disa të cilat i binden pushtetit lokal. Situata e njëjtë vlente edhe për mediet, për të cilat u tha se u mungon dialogu e demokracia. Nga mungesa e organizatave aktive, mungon edhe aktivizmi qytetar, ndërkohë që OJQ-të nuk kanë mbështetje nga donatorët nga vendor apo ndërkombëtar. Shumica e tyre detyrohen të punojnë në baza vullnetare, gjë që nuk premtim qendrueshmëri të këtij sektori. Disa prej aktivitetëve të organizatave u ankuan se, Komuna bashkëpunon me disa biznese të cilave u dhënë subvencione duke u dhënë statutin e shoqatave, ndërkohë që ato shërbejnë më shumë si biznese që dirigjohen nga komuna.

Infrastruktura dhe shërbimet komunale -Në këtë komunë u dha vërejtje për mungesë të rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, ndricimit publik, rrymës, ngrohjes në shkollë dhe menaxhimit të mbeturinave, dhe kjo është më e shprehur në fshatrat përreth. Ka mungesë të ksuhteve në ambulanta, më konkretisht të shtretërve dhe mjeteve bazë të punës, e cila pengon dhënien e ndihmës mjekësore. Pproblem mjaftë serioz në këtë komunë u cilësua prerja ilegale e pyejeve dhe mungesa e mbikqyrjes së komunës në këtë fushë, si dhe mos funksionimi adekuat i menaxhimit të mbeturinave.

Fenomenet negative -Tri çështje të cilat ishin shfaq si probleme të reja pas luftës, e që po e dëmtojnë jashtëzakonisht këtë komunë, janë përdorimi i drogës, kontrabanda në kufi, dhe prostitucioni. Është tejet brengosës që përdorimi i drogës ka marr përmasa të mëdha, ndër kontrabanda në kufi nuk kontrollohet dhe kjo ndodhë sikur të mos ekzistojnë mekanizmat shtetëror. Ndërkraq prostitucioni, përveq imazhit tejet të keq të Komunës, ajo bartë me vete probleme të tjera, sic është stimulimi i dhunës në familje e sidomos tek gratë, gjë e cila është mjaftë prezente në këtë kohë dhe që nuk kursen as fëmijët.

Problemet e Rinisë -Rinia është në masë të madhe e papunë dhe mjaftë pasive. Kjo vërtet si rezultat i punësimit në baza partiake dhe familjare, i cili sistem lënë anash personat të cilët meritojnë vendin e punës. Në këtë komunë pasiviteti i rinisë ndodhë edhe nga mungesa e projekteve dhe mos funksionimi i qendrave rinore, të cilat luajnë një rol të madh në aktivizimin e rinisë. Rinia e kësaj komune është e prekur mjaftë shumë edhe nga narkomania, e që vjen si rezultat i vetëdijes së ultë, edukimit jo adekuat dhe mungesës së politikave shtetërore për t'a angazhuar dhe shfrytëzuar potencialin e saj.

Në këtë komunë, ka shumë fëmijë me nevoja të veçanta, por që prindërit e tyre nuk kanë asnjë mbështetje institucionale. Në vitin 2015 asambleja komuna e ka miratuar planin strategjik të përgatitur nga prindërit dhe organizata OPFA por komuna me resorët e saj nuk është angazhuar në zbatimin e këtij plani. Në Viti ekzistojnë 525 persona me aftësi të kufizuara, e që në plan ishte paraparë që atyre t'u ndihmohej në arsim dhe shëndetësi.

Në takim u kritikua edhe qeveria qendrore dhe lokale për mungesë të politikave adekuate për të shfrytëzuar tokën. Komuna e Vitisë njihet për tokë pjellore, por kjo nuk shfrytëzohet, ndërkohë që toka ka mbetur djerrinë madje edhe është uzurpuar.

Rekomandime

- Shteti urgjentisht duhet të ndërmerr hapa drejtë luftimit të përhapjes së narkomanisë, prostitucionit dhe kontrabandës në kufi
- Duhet të riaktivizohet dhe mbështetet shoqëria civile përmes granteve dhe donacioeve
- Duhet të rritet punësimi dhe aktivizimi i rinisë në aspektin kulturor dhe sportiv
- Duhet t'i kushtohet vëmendje personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre
- Duhet të ndërmerren masa urgjente për mbrojtjen e ambientit
- Duhet të intervenohet sa më shpejt në ndërtimin e infrastrukturës në fshatra

10. Komuna e Vushtrisë

Si problem kryesor, kjo komunë adresoi papunësinë, e sidomos tek të rinjtë e cila është në shkallë tejet të lartë. Si rezultat i kësaj, Vushtrria ishte e dyta prej komunave që emigruan ilegalisht gjatë eksodit të vitit 2014. Ndërkohë, kaluan 3 vite dhe ende asgjë nuk u ndërmarr për t'a përmirësuar gjendjen. Ka një pasivitet të madh të rinisë në Vushtri, gjë që ndodhë për shkak të mos funksionimit të shtëpise së kulturës, mungesës së terreneve sportive si dhe mungesës së politikave adekuate që do t'a përmirësonin gjendjen. Në këtë komunë, ka mungesë të projekteve për emancipimin e qytetarëve, të cilat po të ekzistonin do ta kishin përmirësuar dukshëm mënyrën se si funksionon aktualisht kjo komunë.

Gjithashtu, potenciali për zhvillimin e turizmit nuk shfrytëzohet fare, ngase komuna nuk qeveriset nga njerëz të cilët janë kompetent dhe kanë vizion për të shfrytëzuar monumentet dhe ndertesat e lashta që ekzistojnë. Qyteti po vazhdon të degradohet cdo ditë nga ndërtimet ilegale të cilat gradualisht po e zhdukin pasurinë e vjetër në arkitektuale. Gjithashtu, mirëmbajtje nuk ka as Kalaja e qytetit, e cila është edhe e vetmja pasuri arkitektuale me potencial për zhvillimin e turizmit. Madje ehe përkunder investimeve të bëra nga USAID, Kalaja vazhdon të mos ketë vëmendjen e komunës për ta mirembajtur dhe trajtuar si duhet.

Ndërkaq, me gjithë potencialin në sektorin e bujqësisë që ka, ku 50% e tokës është tokë bujqësore, ajo nuk arrin të shfrytëzohet dhe punohet, për shkak të mungesës së përkrahjes me subvencione nga shteti. Ka ndotje enorme të lumit Sitnica, i cili cdo ditë e më shumë po degradohet nga bizneset private dhe individët, duke shkaktuar kundermim në qytet dhe bakterie të rrezikshme për shëndetin e banorëve të Vushtrisë.

Rekomandimet

- Ndërmarrja e masave të duhura për uljen e nivelit të papunësisë
- Funksionalizimi i shtëpisë së kulturës, qendrës rinore dhe terreneve sportive për aktivizimin e rinisë
- Shfrytëzimi i monumenteve kulturore për të zhvilluar turizmin dhe ekonominë
- Mirëmbajtja e duhur e Kalasë së qytetit
- Zhvillimi i projekteve për emancipim qytetar
- Krijimi i projekteve për zhvillim e bujqësisë
- Pastrimi dhe rregullimi i qytetit